

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëherë, Mirëdita të gjithëve. Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së muajit Janar, por njëkohësisht dhe mbledhja e parë për vitin 2026, në të cilën gjej rastin t'ju uroj të gjithëve një bashkëpunim sa më të frytshëm në interes të vendimmarrjes, që do të thotë në interes të qytetarëve. Para se të fillojmë, do kisha, meqë jemi më të qetë, do të kisha një sugjerim ose një propozim që e diskutuam me kryesinë, bashkë me Zamirin dhe me Jetën, lidhur mbi çka na ngarkon ligji për vetqeverisjen vendore përsa i përket përmirësimit dhe rregullimit të rregullores të funksionimit të Këshillit Bashkiak. Kjo është një rregullore që është përgatitur dhe funksionon sot e disa vjet, por ka ardhur një moment që ne shpeshherë e kemi diskutuar që ka vend për të rregulluar dhe për të përmirësuar disa gjëra. Pra, unë do t'i kërkoja grupit të komisionit, i cili merret me problemet dhe çështjet e ligjit, ku përbëhet nga zonja Luiza, Andi Shtylla, Majlinda Kaçulli, Arbër Fetahu, Eva Bica, Erion Murataj. Gjithashtu ka qenë dhe Blendi, i cili është zëvendësuar me anëtarin e këshillit, por unë do ta sugjeroja nëse grupi përkatës do të kishte një jurist, do ishte mirë që të ishin në këtë komision. Pra, ky komision mendoj që më nga data 20 duhet të jetë mbledhur dhe të sugjerojë disa gjëra lidhur me rregullimin dhe përmirësimin e rregullores. Kjo nuk do të thotë që, ose më mirë, me ja lënë në detyrë të gjithëve anëtarëve të këshillit, të cilët e shohin të arsyeshme dhe të nevojshme për të përmirësuar ndonjë nen ose ndonjë pjesë, ndonjë fragment të rregullores, le ta sjellim me shkrim pranë sekretariatit të këshillit brenda datës 15, që në fund të gjitha këto të përkthehen në përmirësimin e rregullores. Ne, si kryesi, marrim përsipër që juristët e bashkisë, bashkë me bashkitë e forta, do ta kenë asistencën përkatëse në çdo moment. Pra, kjo është një detyrë që unë po them që duhet vlerësuar dhe duhet të përmirësohet me detyrimisht. Gjithashtu kishte dhe një sugjerim, më fal. Kishte edhe një sugjerim lidhur me procedurën që ne e

ndjekim përse i përket mbledhjes, pasi relatohet nga përfaqësuesi i bashkisë apo dhe kryetari i komisionit përkatës, ne ua japim fjalën grupeve përkatëse si masë e radhës. Po, kjo nuk do të thotë, sepse më shkas nga propozimi i Altinit , që duhet të flasim edhe ne, ose kjo nuk do të thotë që detyrimisht kryetari i grupit duhet të flasë, por një nga grupi përkatës mund të flasë dhe kjo mund të mbyllet në mënyrë edhe më racionale, edhe më shpejt, edhe më duke mos lënë hapësirë që të diskutojmë të njëjtat gjëra, edhe duke shtyrë kohë pa vend. Po, zonja Luiza, ç'e kishte?

Luiza Popja-Antare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Lidhur me kërkesën për ndryshimin e rregullores, patjetër Komisioni i Ligjit dhe Rregullores shpreh gatishmërinë që të ketë ndryshime, të rishikohet, por kërkojmë që secili nga anëtarët e këshillit bashkiak, por edhe grupet e këshilltarëve, në rast se kanë ndonjë pretendim, ndonjë kërkesë, ndonjë sugjerim, ta depozitojnë atë pranë sekretariatit të këshillit, i cili na e vë në dispozicion. Njëkohësisht, të gjitha këto projektpropozime dhe ndryshime do të konsultohen edhe me ekspertin e bashkive të forta, sepse bashkitë e forta do ta theksojmë që kanë qenë gjatë gjithë kohës bashkëudhëtarët të shqyrtimit dhe propozimeve për projektregulloren që ne kemi aktualisht rregullore. Kështu që do të kërkoja patjetër bashkëpunimin edhe të anëtarëve të tjerë të këshillit bashkiak. Faleminderit.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Vetëm vlerësojeni, sepse kemi diskutuar gati një vit dhe nuk kemi marrë asnjë hap konkret. Atëherë, gjithashtu në mbledhje është i pranishëm Nënkryetari zoti Asim, bashkë me drejtuesit përkatës sipas çështjeve që ka në rend ditës. Fillojmë me apelin.

Elsid Zyma-Sekretari I Këshillit Bashkiak Elbasan

Sekretari i këshillit bashkiak bën apelin. Marrin pjesë 37 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Do të votohet me në mënyrë elektronike, por duke qenë se minutë pas minute shtohet anëtarët e këshillit, do ishte mirë që prej po lexohet. Atëherë, hapet votimi?

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak miraton me shumicën e votave


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak .

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan


Pika e 2 e rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të muajit Dhjetor.

Këshilli Bashkiak miraton me shumicën e votave

Mbajtëse e Procesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 3 e rendit të ditës.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Dhjetor 2025.

Rexhep Kaculi-Anëtar I Këshilli Bashkiak Elbasan

Përshëndetje. Për sa i përket ndihmës ekonomike, mendoj që nuk ka ndonjë problem për të diskutuar. Bashkë me këtë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë edhe nga fondi i kurçizuar, kemi edhe dy pika të tjera, katër dhe pesë, për miratimin e kriterëve. Këto kanë rëndësinë e tyre, sepse shumicë, një pjesë nuk na i kalon, ka raste që nuk kalon sistemi elektronik. Këto kanë rëndësinë e vetë që të bëhen të qarta njerëzve, me një fjalë, për këto, për të plotësuar formularin e pikëzimit. Kështu që unë them t'i kalojmë. Të reshim, 3.3.1, 4, 5.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Do kishte nevojë ne një sqarim? Ka ndonjë pyetje në gjë?

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim E.Muzhaqi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 3/1 e rendit të ditës.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Dhjetor 2025.

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim E.Muzhaqi)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 4 e rendit të ditës.

Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim E.Muzhaqi.B.Copja.A.Kana,A.Mecja)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 5 e rendit të ditës.

Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Më është kas nga një shqetësim i banorit të Elbasanit. Nuk e di nëse përkon me këtë pikë apo jo, por kam detyrë ta transmetoj si shqetësim. Është familjar me tre fëmijë, palë e vetme prindërore, pa punë, pa ndihmë, dhe i kishin nxjerrë ndihmën ekonomike dhe thanë në bashki, thanë që është bërë gabim, gabim elektronik. Sigurisht që unë nuk po e ngre si shqetësim zyrtar, prandaj që e kam bërë me shkrim, edhe du që drejtoria përkatëse ta konsultojë me mu emrin privatisht edhe t'i japin mundësisht një zgjidhje, pastaj rastet e përgjithshme, pastaj të tjerat të merren ashtu. Ishte rasti çik i çuditshëm, më thanë të drejtën, edhe du që ta. Ju lutem, kush e mbulon nga juve, ta trajtojmë. Faleminderit.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, - kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim B.Copja.A.Kana,R.Mita)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 6 e rendit të ditës.

Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjentit me emërtim Ish-Godina e Partive Politike (kati i tretë), Z.K 8524, Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANC nga Bashkia Elbasan.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo u diskutuar dhe në mbledhjen e parë, dhe s'besoj që do ketë nevojë për të diskutuar.

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, 7 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim R.Mita)

V.K(V.Kundra

Y.Balliu.B.Copja,A.Domi.A.Kana,E.Muzhaqi,Z.Muzahqi,A.Mecja)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kemi një përmisim tek ligji 139, gërma e1.

Unë po të them kalon sepse me vendimin e qeverisë .Po çfarë po të them tani? Ke e-ja është miratimi i tjetërsimit i pronave të treta, kërkon 31 vota. Pra, miratimi dhe tjetërsimi i pronave kërkon këtë,e1, dhënia në përdorim në pronësi të tretëve ose dhënia për zhvillim pronësie kërkon 26. Pra, është ndarë, po duhet të kishte kaluar.

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 7 e rendit të ditës.

Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A.Bradashesh nga Bashkia Elbasan.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kisha diçka në lidhje me këto dhëniet në qera dhe në përdorim. Qëllimisht e kalova fjalën time në këtë mbledhje dhe jo në mbledhjen e kaluar, se shqetësimi në fakt nisi nga mbledhja e kaluar që u miratuan ato bar kafe ke pallati i sportit dhe ke këto diçka e tillë edhe ca të tjera. Por që të kuptohet që nuk kam personale me njerëzit, por e kam parimore, desha të them që në fakt ne duhet të kemi dhe një mekanizëm kontrolli jo vetëm ekonomik të këtyre gjërave, sepse me një farë mënyre janë asete të qytetit. Konkretisht, këto kafe që janë te pallati i sportit, sidomos në mënyrë të veçantë, janë edhe kanë edhe funksion përfaqësues. Pra, aty edhe sportdashësit tanë shkojnë, edhe udhëtarët tanë shkojnë, edhe vizitorët që vijnë nga jashtë shkojnë. Kanë vite dhe vite dhe vite që jepen me qera ato aty dhe shumë mirë që jepen, se do bashkia asnjë investim, asnjë zbulim, asnjë lyerje të paktën që t'i shohin qytetarët që ka lloj gjëje në mes të qytetit, të kupton se është sport, është kulturë, është traditë e qytetit tonë. E para. E dyta, kam pasur edhe incidentë të pakëndshëm aty një apo dy herë, një lloj arrogancë të pashpjegueshme. Dikush nga ato, prapë nuk e kam personal, por duhet të kontrollohet nga bashkia, i futi të zabtume me parkimit publik aty dhe çon edhe kamarierin me britma që mos parko këtu, mos parko aty në parkim publik. Domethënë, mirë që po e marrin me qera po të njëjtët njerëz tradicionalisht, edhe thashë nuk e kam hallin sepse mos marrin, se dikush do e marri, mirë le ta marrin këto. Mirë që po paguajnë një gjë që

për mendimin tim duhet të jenë tarifa më të bollshme për përfitim të bashkisë. Të paktën t'i kthejnë një gjë atij vendi, janë mes qytetit. Një pjesë. Ka të tjerë që janë çik më bodrum thanë ti këtu. S'ka problem, por në mes të qytetit kafe vijnë sportdashës, vijnë vizitorë nga rrethet e tjera në qytete të tjera, edhe të rrim përherë e shumë, unë mendoj që sektori përkatës i bashkisë duhet të shtojë lloj presioni tashi. Nuk mund t'i lëmë vetëm kaq. Merre aty për dy çika lekësh Kemi shokë kemi mik, kemi shokë kemi mik, kemi qytetin shokë e mik. Është investim që bëhet për qytetin. Zbukurim që bëhet për qytetin dhe atë arrogancën po e shtrojnë këshill bashkiak. Ka dhe lloj arrogancë në drejtim të zaptimit të parkimeve publike aty me lloj lloj kanaqesh, me lloj lloj gjërash edhe me të fortë mos parko këtu. Përveç vizave të verdha që i kanë pagua, se ka nja dy tre hapësira që janë me viza të verdha të pagu me, përveç këtyre dhe atë dy tre shtesë. Edhe ky është një shqetësim që duhet ta ngrijë në këshillin bashkiak edhe sektori përkatës në bashki duhet ta ketë parasysh këtë.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Për mua është një shqetësim i drejtë dhe u bashkohem me juve. Kjo është një sugjerim për ta pasur parasysh zotën nënkryetar me strukturat përkatëse.

Asim Sula-Nënkryetari I Bashkisë Elbasan

Çështja e qëllimit është çështja e drejtë. Nëse rezulton kështu, do ta verifikojnë nëpërmjet policisë bashkiake edhe do të sistemohet shumë shpejt situata. Do të vendoset në një kontroll. Faleminderit për ngritjen e çështjeve të drejta. Sigurisht që janë në dobi të komunitetit dhe do t'ju shtrojmë shumë shpejt për zgjidhje. Faleminderit.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim R.Mita)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 8 e rendit të ditës.

Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Ndërtimi i rrugës rrotonda e varrezeve -intersektimi i rrugës “Nos Josif”, ndodhur në Z.K 8522 dhe 8527”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”.

Marvi Avllazagaj-Perfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

Përsëritje. Atëherë, referuar për titull të projektit që u citua më parë nga kryetari i Këshillit Bashkiak, bëhet fjalë për intersektim për rrugën lidhëse nga Rotonda e Varrezave deri në intersektim me rrugën Nos-Josifi, që është në zonën e lagjes së Emin Matraxhiu. Është një rrugë me një rëndësi të veçantë dhe duhet një investim imediat, pasi e gjithë zona ka vetëm një mundësi komunikimi nëpërmjet të rrugës së Krasës. Pra, vetja dalje është në pjesën tek zona e Krasës. Rrethi lidhet me rrugën e vjetër që është në tek zona e banuar. Është një rrugë e cila ka parametra urbanë sipas planit të përgjithshëm vendor, me të gjitha shtresat e saj. Janë parashikuar trotuar në të dy anët, korsitë biçikletash, gjelbërimi dhe ndriçimi bashkë me kanalizimet përkatëse, infrastrukturën tokësore përkatëse. Është kërkesë e ka hershme dhe nga vetë komuniteti, i cili ka një problematikë. Më parë ato komunikimin nëpërmjet rrugës në Nos-Josifi me intersektimin me unazën Çerçiz-Topolli, me një nënkallim, i cili ka qenë problematik shpesh herë me aksidente të vazhdueshme, qoftë me jetë njerëzish, qoftë me makina. Me këtë arrijmë të japim një zgjidhje komode të gjithë zonës, duke krijuar dhe një unazë për gjithë lagjen Emir Matraxhiu

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kisha një pyetje për zotërinë që se marr shkas edhe nga ajo që ndodhi takimi në terren atje që pak a shumë e dimë se si është situata dhe ishte dhe kërkesë e banorëve kjo rrugë dhe ato ishin dakord që kjo rrugë të kalonte. Projektin ata nuk e dimë, por në parim ishin dakord, por ato kishin një problem me edhe mbylljen e nënkalimit që për t'i aksesuar atje dhe me fjalë te kjo rrugë që do dali, me fjalë ai aksesim do të rivihet në punë apo do të jetë thjesht do të lidhet me këtë rrugën këtu dhe do t'i jap akses vetëm këtyre banorëve që banojnë këtu dhe normalisht atë ai fluksi që do të vijë nga qyteti, por duke qenë se nënkalimi këtu është i mbyllur, gjithë fluksi do të shkojë drejt Krastës dhe pastaj do devijojë në drejtim majtas për të dalë në unazë dhe kërkesa e qytetarëve është që edhe ajo nënkalimi poshtë urës të shikohet nëse ka diçka në dorë bashkia, duke respektuar normalisht edhe elementët e sigurisë rrugore, sepse është ajo është një njollë e zezë në qytetin e Elbasanit që aty fatkeqësisht kanë humbur shumë qytetarë jetën. Plus do kisha diçka tjetër për të shtuar te ky projekt, se parimisht unë të jam dakord që të bëhet, se ishte dhe kërkesë e banorëve, nuk dua që të jem kundër dëshirës së banorëve, por të keni parasysh se këtu shumë afër keni dhe një rrugë tjetër e cila është përgjatë shinave të trenit dhe nëse kur të bëni këtë projektin të bëni dhe një dalje që të lidhet dhe kjo rruga anësore që të aksesohet edhe nga krahu tjetër, që të ketë dy. Se është shumë pak me fjalë me uljet nëse do e shihni të arsyeshme në projektin që do të bëni. Plus që rishikojeni se nga pamjet duket që ka disa objekte që duhen shpronësuar aty, nëse janë banesa apo janë thjesht, janë thjesht nuk e di me fjalë kasolle siç e quajnë rëndom qytetarët apo vend për kafshët, nuk e di se çfarë janë, por nga lart duken si çati shtëpie. Dhe tjetra është që për atë çështjen që e diskutoam dhe për çështjen e Varrezave, po e ngre meqë është e përhapur te kjo pikë, sot ka ardhur koha që ne si qytet të fillojmë të mendojmë që çfarë do të bëjmë me ata të cilët ndërrojnë jetë prej të afërmeve tanë, sepse siç e dimë vendi ku ata prehen dita ditës nga masiviteti, fatkeqësisht i humbjes së jetës së qytetarëve, por dhe nga shtimi i popullsisë dhe jo vetëm, por dhe nga shumë, siç argumentojnë shumë ekspertë të shëndetit publik prej stresit apo prej ndotjes, fatkeqësisht ka shumë humbje jete dhe pronat atje ku është parashikuar për të qenë varrezat për t'u prehur qytetarët tanë po ezaurohet me shpejtësi. Dhe nuk e di se sa prona ka akoma në dispozicion bashkia dhe sa mundësi ka bashkia që të zgjidhet. Plus që marr shkas dhe nga ankesat e banorëve që ishte ai problemi që do ta diskutojmë në

mbledhjen e ardhshme dhe ne si këshill t'i hapim rrugën një diskutimi në mbledhjen e ardhshme për , për zhvendosjen ose për zgjerimin në mënyrë të drejtë dhe proporcionale dhe jo kundër interesave të qytetarëve për atë çështje. Po e meqë integrova, meqë mos e merrja prap.

Marvi Avllazagaj-Perfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

Referuar kërkesave të bëra në lidhje me po e marr nga fundi me nënkalimin që i cili ndodhet në Belebe poshtë linjës së korridorit, ai nënkalim nuk është në është cilësuar i në kundërshtim me të gjithë rregulloren e transportit, pasi unaza Çerçiz-Topolli është fond i ARSH-së. Është bërë një kërkesë nga institucioni ARSH-së për t'i dorëzuar bashkisë Elbasan, e cila ende ne nuk e kemi marrë në dorëzim, por kemi dërguar me një shkresë për përmirësimin e situatës asfaltike të unazës, e cila tashmë ka pësuar një amortizim prej shumë vitesh në cilësinë e një aksi nacional dhe me bërjen e rrugës së re nuk do të jetë e aksesueshme, pasi është burim aksidentesh dhe konfliktesh qoftë për këmbësorët, qoftë për automjetet. Prandaj dhe ne po nxitojmë me një projekt të tillë për t'i dhënë një mënyrë aksesimi sa më të sigurt, sa më komod të gjithë komunitetit të asaj zone.

Këshilli Bashkiak me 38 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Dritan Ceca-Anëtar i Këshillit Bashkia Elbasan

Duhet të ngrej një shqetësim. Mbledhjen e fundit të nëntorit këshillit bashkiak, unë i kam bërë një kërkesë kryetarit të bashkisë, i cili ishte prezent për sa i përket të gjendjes së rrugëve në qytetin e Elbasanit, duke iu referuar kontraktorit të shoqërisë ujësjellës të kanalizimeve. Më është deklaruar nga kryetari në përgjegjësi personale që brenda dhjetorit kontrata përfundonte dhe rrugët do ishin rehabilituar. Po t'i referohem realiteti sot, situata është bërë akoma më kaotike, akoma më e turpshme dhe ndikon te cilësia e jetës së gjithsecilit nga ne. Faktikisht, unë e doja përgjigjen nga kryetari, por meqë është nënkryetari, mund të më përgjigjet, po minimalisht bashkia e Elbasanit duhet të jetë e përgjegjshme, sepse është pronare e rrugëve të qytetit dhe e aseteve.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkia Elbasan

Faleminderit. Në vazhden e kësaj është një kërkesë nga anëtarët e këshillit me përfaqësues zotin Ergys .Ka ardhur me shkrim, e është çuar UKE-së, çka është ndërmarrjes, ka ardhur përgjigje që ne do të vijmë edhe do të mbledhemi gjithë bashkërisht për të bërë një dëgjese enkas vetëm për këtë çështje. Pra, kjo do të ndodhi marrë nga data 10 shkurt 2024.

Dritan Ceca-Anëtar i Këshillit Bashkia Elbasan

Duke shty një muaj, shty dy, shty tre, jashtë kontratës pasoja aktivuajnë qytetarët e Elbasanit dhe mu më duket mungesë serioziteti nga ana e bashkisë, e cila është e rrethkësuar, pronare e aseteve publike në bashki, që mos kishte marrë masa deri sot. Në një moment që subjektit i ka mbaruar kontrata, çka është më e rëndësishmja, dhe subjektin nuk do t'i asfaltojë ato kur të ketë dëshirë. Dhe e dyta, unë pres përgjigje nga zoti Asim të zhvilluar përgjigjen për këtë problem dhe shqetësimi i dytë që doja të ngrija që janë të gjithë mundësitë e bashkisë, ka të bëjë me kryqëzimin e Cërrikut. Është bërë një tmerr dhe turp për qytetin e Elbasanit. Semaforët janë vonë, të bëni një studim se me shumë pak shpenzime të rehabilitohet ajo lloj nyje, sepse ditët e fundjavave ka një fluks. Është dhe rrugë nacionale, qoftë dhe në bashkëkreditim me drejtorinë me ARSH-në, me drejtorinë e përgjithshme të rrugëve. Janë gjëra shumë të vogla, por që ndikojnë te cilësia e jetës së qytetarëve. Faleminderit.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ke e para ndërhyra, sepse thashë duke pasur një informacion, duhet të kërkoj edhe këshilltarëve që do të keni një njoftim marrë nga data 10 për një interpelancë që e cila do të bëhet dhe për një çështje tjetër, por bashkë dhe me ujësjellës kanalizimin. Edhe përgjigja nga këto me shkrim dhe me vulë vjen për arsye objektive të papërgatitura, ne jemi gati pas datës dy, që do të thotë brënda datës 10, pra do të mbledhemi enkas vetëm për dy çështje, jo mbledhje për të diskutuar gjëra të tjera, pra që të japim një rëndësi më shumë se sa ka qenë.

Dritan Cepa-Anëtar I Këshillit Bashkika Elbasan

Unë jam dakord, por po vazhdojnë të hapen gropa dhe sot, çdo ditë, në çdo rrugicë të Elbasanit, cep më cep hapen gropa, nuk është se ato janë procese rehabilitimi të gropave aktuale.

Asim Sula-Nënkryetari I Bashkisë Elbasan

Faleminderit për ngritjen e shqetësimit, sigurisht është shqetësim i drejtë dhe i përket të gjithë qytetarëve të Elbasanit, na përket ne të gjithëve. Është një proces që ne e kemi ndjekur me vëmendje dhe sigurisht kemi çuar shumë shkresa për marrje masash. Të gjithë duam që ky proces të mbyllet, por sigurisht që për arsye teknike rihapet, sepse do të thotë që ka problem teknik dhe nuk mund ta lëmë, nuk mund ta lëjë kompania një problem që lind të mos arrijë hapje dhe ta lëjë ashtu. Pra, kanë dalë probleme gjatë procesit të testimit. Gjithsesi, siç e theksoi dhe kryetari i këshillit, do të jetë një dëgjësë apostafat për këtë çështje që do sqarohen të gjitha aspektet. Duhet të jemi të duruar, është sigurisht që është në të mirë të komunitetit, është drejt procesit të mbylljes edhe kjo kontratë. Faleminderit.

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 9 e rendit të ditës.

Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagjia “Kongresi Elbasanit” nga Bashkia Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga




Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 10 e rendit të ditës.

Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit.ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “Onufri”, nga Bashkia Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, - kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim Z.Muzhaqi,D.Cepa)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 11 e rendit të ditës.

Për miratimin e tarifës së shitjes, dru zjarri, për nevojat e banorëve të Bashkisë Elbasan.

Jakov Bodurri-Përfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

Atëherë, si çdo vit, edhe këtë vit ne drejtohem i këshillit bashkiak për miratimin e tarifës së shitjes. Pra, miratimin e tarifës së shitjes së materialit drusor, dru zjarri për nevojat e banorëve të qytetit të Elbasanit, por dhe të rrethinave në afërsi. Për t'i paraprir kësaj, bashkia Elbasan ka kontraktuar shërbimin e prodhimit të drurëve zjarrit gjatë vitit 2025, është mbyllur kjo kontratë, materiali dërrësor është depozituar në fushën e përcaktuar nga bashkia, edhe ne sot jemi i drejtohem i këshillit për miratimin e kësaj tarife. Po ta shikoni edhe në materialin që kemi referuar, është marrë në përcaktimin e këtij çmimi, është marrë në konsideratë kostoja e prodhimit të materialit drusor, dru zjarri nga ngasat pyjore deri në fushën e bashkisë, edhe tarifa e përcaktuar sipas VKM-së 559, që është një tarifë e detyrueshme për të gjithë për shitjen e materialit drusorë. Por dhe një vlerë e vogël, pra 7 lekë për metër sferë, që është vlera që vjen si rezultat i vlerës së vërtetimit të transportit që marrin mjetet që transportojnë këtë material drusorë. Po t'i marrim në konsideratë të gjitha këto vlera, ne këtu, po ta shikoni, kemi ka një lapsus, është diku ke rreth 5 lekë, do të jetë më pak, pra jo 4180, por do të jetë 4175 lekë për metër sferë, që do ta marrin banorët e Elbasanit pas miratimit në këshillin bashkiak. Ne, edhe gjatë vitit të kaluar, por edhe gjatë këtij viti, me fjalë bashkia nuk ka pasur asnjë lloj kufizimi lidhur me furnizimin me drurë zjarri. Pra, çka do të them, nuk ka pasur asnjë kufizim. Nuk ka pasur procedura burokratike për pajisje

me dokumenta apo diçka tjetër, mjafton vetëm një mandat arktimi pranë fushës së depozitimit dhe për gjithë mjetet transportuese pastaj që e marrin për ta çuar nga fusha e depozitimit deri në banesën e tyre, ne i pajisim dhe me një vërtetim transporti që është një dokument i cili e përcakton ligji.

Aurora Domi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Sa ka qenë dhe sa është? Sa është viti?

Jakov Bodurri-Përfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

Po, atëherë pyetja është shumë e drejtë, e lidhur në këtë vit, e çmimi i shitjes së drurëve zjarrit vitin që kaloi, pra që e kemi rrethuar në fillim të vitit 2025, ka qenë 4495 lekë, kurse sot vjen në zbritje, pra 4175 lekë, pra ulët rreth 2000 ca lekë për metër. Kjo ka ardhur si rezultat i uljes së kostos së prodhimit, i cili vjen si rezultat i elementeve teknike që ndodhin në terren. Pra, çmimi ka ardhur në ulje.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pyetje tjetër? Po?

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kam një lloj shqetësimi, në fakt, se mirë është të ngrohemi me drurë zjarri, shumë mirë është, por në një farë mënyre edhe konfigurimi arkitekturor i qytetit ka evoluar dhe ka ndryshuar, edhe shtimi i makinave ka bërë ndotjen në qytet që e njimë të gjithë, varim rrobet në ballkon, nuk i marrim sic I nxjerrim nga lavatracja i marrim me erë të keqe. Bashkia, mos kemi ndonjë studim i cili na tregon sa konsumohet druni i zjarrit për ngroftje, sa e kanë të domosdoshëm se nuk kanë mundësi tjetër, edhe sa e kanë çështje luksi, në mënyrë që ndoshta ky këshill, ndoshta i këshillë tjetër, të bëjë hapin çik më ekologjik edhe të shohim mundësira çik më të pastra. E kam shqetësimin, jo se du me i prish punë këtyre, se po të themi dhe njëherë, ne kemi traditë edhe mirëbëhet, po ne jetojme në pallate. Unë sot jetoj në kat pesë. Komshillarët me shpi përdhese, shqyr Zotit, nezin drurë zjarri, nuk hyjet në pallat, në ballkon jo e jo. Kështu që a ka marrë ndonjë nismë kësaj natyre bashkia që të na sqarojë çik më shumë, a kemi mundësi të rregullojmë diçka në këtë mes? A nuk po them për të shitur, si e kemi këtë problem, në qoftë se ka

mundësi? Këtë herë, në qoftë se s'ka mundësi, e trajtojmë ndryshe herë tjetër, po aq interesante mendoj unë.

Jakov Bodurri-Përfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

Pyetja është mjaft e drejtë dhe interesante, sepse normalisht të gjithë jemi interesuar për të pasur një mjedis sa më të pasur, por institucioni që ne jemi, unë jam pjesëtar i drejtorisë së pyjeve, nuk ka bërë një studim të mirëfilltë, sepse këtu besoj që duhet të përfshihen edhe struktura të tjera të bashkisë për të pasur një, si të thuash, një studim të saktë dhe mjaft të detajuar, për të pasur pastaj një rezultat të cilin ne duhet ta paraqesim. Ndoshta kjo mbetet për të ardhmen, që për vitin që vjen ne ta marrim në konsideratë kërkesë edhe të kemi si të thuash një shifër mbas së cilit pastaj do të planifikojmë masat që të marrim në të ardhme për furnizimin me drurë zjarri, por dhe masat e tjera në respekt të mbrojtjes së mjedisit.

Jo, një gjë duhet ta themi, duhet ta themi mjaft hapur dhe pak, nga përvoja ime që kam në bashkinë Elbasan gjatë këtyre 10 viteve të fundit, do të them që në qoftë se para dy viteve ne kishim një fenomen të tillë që kërkesa për drurë zjarri ishte maksimale, biles kemi shkuar deri aty sa të ne t'i diferencojmë kërkesat për furnizimin me drurë zjarri duke lehtësuar grupet që janë më të marginalizuar, që janë pensionistët, ato familjet që janë me ndihmë ekonomike të tjerë. Kurse ç'na ka ndodhur vitin që kaloi dhe këtë vit, pra kërkesat kanë qenë në ulje, pra në ulje do të them gati 50% më pak, dhe kjo na ka bërë dhe ne thashë që ne t'i heqim çdo lloj barriere për furnizimin me drurë zjarri.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Okej, kjo ishte një përgjigje e saktë. Po janë marrë masat. Për dy vjet ti ke 50% të drurëve që digjen më pak, do të thotë që po vazhdojmë drejt eliminimit të zjarrit, ngrohjes me dru.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (Vota Abstenim E.Muzhaqi,A.Mecja)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 12 e rendit të ditës.

Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për Automjete motorrike në administrim të ASHPU për vitin 2026”.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Siç e diskutuam edhe në komision, janë disa mjete që duken që nga konsumi i litrave të karburantit është shumë i lartë, siç është ky kamion benz 45 litra për 100 kilometra, është konsum i lartë, duke e ndërlidhur edhe me fjalën e zotit Ergys që për ndotjen që ngriti shqetësimin nga drurët e zjarrit, edhe kjo është një ndotje e panevojshme. Unë besoj që bashkia duhet të shikojë në, kur kalon këto pika, të shikojë mjetet në çfarë gjendje i ka, se mund të na dalim me leverdi që me kaq litra sa na konsumon ky mjet, na leverdis më shumë të blejmë një të ri, sa të miratojmë miratimin për këtë mjet me 45 litra për 100 kilometra, që më duket shumë për në kohën ku jetojmë. Shikojeni këtë gjë, Le që është edhe nga ana financiare shpenzimi i kotë, por dhe nga ana mjedisore një ndotje e panevojshme. Na bie më lirë që për një vit, dy vjet, duke kursyer lekët e karburantit, ne blejmë mjet të ri. Shikojeni këtë si problematikë. Faleminderit.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Dëgjojmë përgjigjen e përfaqësuesit.

Përfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

Përshëndetje. Për sa i përket mjetit kamion, mjeti është një normativë e transmetuar nga ISH ASHP, është me të gjithë kushtet standarde, i kualifikuar me të gjithë normat e punës, është i vetmi mjet që ne na ndihmon për të kryer transportin e mbetjeve inerteve, është mjet që përdoret vetëm brenda qytetit dhe prandaj është ajo normativë e provuar me procesverbal, e audituar dhe nuk mendoj që është e mbifryer si normativ për sa i përket këtij mjeti, sepse është me një kapacitet mbajtës 18 tonë dhe me një fuqi motorike 18 mijë centimetër kub. I vitit 2000. Patjetër është vlerësim shumë i mirë për t'u dhënë ideja e marrjes së një mjeti të ri, por për momentin është i vetmi kamion që institucioni zotëron për kryerjen e kësaj pune.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 2 kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(Vota Kundra E.Muzhaqi,A.Domi)

V.A (Vota Abstenim Y.Balliu,D.Cepa,E.Jaurri,R.Mita,A.Kana)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 13 e rendit të ditës.

Për miratimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për projektin: "Transformimi ligjor dhe rregullator për eficientë të përmirësuar të energjisë".

Kristina Kreka-Përfaqësuese e administratës Bashkia Elbasan

Pjesa e matshmërisë në kohë ka të bëjë me dokumentacionin e plotë që ju keni në dosjen e aplikimit. Projekti konsiston në një grant të përfituar nga Bashkia e Elbasanit, në kuadër të një aplikimi të bërë nga Bashkia e Elbasan drejt thirrjes së hapur nga OSF-së estere Balkan. Është një projekt i cili, pa diskutim, Bashkia e Elbasanit do të ketë në dukshmëri përmirësimin e kuadrit ligjor për çështjet e efikasitetit të energjisë. Është një fazë e dytë e projektit të fituar nga Bashkia e Elbasanit për shtatë shkollat të fituara më parë, para dy vitesh, në të cilat është investuar në këto shkolla për instalimin e paneleve diellore. Është konstatuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit dhe nga ekspertët lokalë që ka tepriçë të energjisë, për të cilën realisht njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një vakum ligjor për pjesën e kthimit të kësaj tepriçë në investime dhe, duke qenë, duke marrë së punë të pikërisht nga analiza, kemi aplikuar në këtë projekt i cili do të konsistojë në ngritjen e një komiteti i cili do të merret me çështjet ligjore, të vakumit ligjor, në aspektin e problematikave që hasin sot njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në analizat financiare se si ky investim i bërë më parë, që sot realisht është kosto, për shkak se teprica e energjisë nuk kthehet në investim, do të mund të llobohet nga pushteti vendor, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejt pushtetit qendror dhe përmirësimit të kuadrit ligjor. Të gjithë mekanizmin e ciklit të procesit i cili zgjat për 12 muaj e keni të elaboruar në plane konkrete aktivitete. Bashkia e Elbasanit ka zero bashkëfinancim. E vetmja gjë është TVSH-ja, për të cilën realisht thirrjet e

hapura nga donacionet nuk mbulojnë TVSH-në, por për të cilën bashkia do t'i drejtohet SASPAK-ut dhe pjesa e TVSH-së do të mbulohet nga Agjencia përkatëse dhe realisht bashkia do të ketë një vlerë të shtuar që është pikërisht ekspertiza dhe ngritja e kapaciteteve për strukturat e bashkisë, në mënyrë që këtë, le të themi, studim, le të themi, studim i fizibilitetit për çështjet e efikasitetit të energjisë në shtatë shkollat e pilotuara më parë nga projekti OSF esteri Balkan, të kthehet në një investim në qëndrueshmëri dhe vlerësim të ardhurash për institucionet dhe një lobim si një mekanizëm i cili duhet të unifikohet për gjithë njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore me kuadra ligjore të përmirësuara. Nëse ka pyetje, fondi total është 59,900 euro, të cilën e keni të elaboruar në planin e buxhetit të planit të masave që do të ketë konkretisht në zbatim të projektit përgjatë 12 viteve të zbatimit të tij. Çfarë do të bëhet për zbatimin e projektit? Cilat janë detyrimet që ka njësitë e vetëqeverisjes vendore nga njëra anë dhe fondi total 59,900 euro, që është fondi total i cili do të ekzekutohet për implementimin e projektit? Vetë projekti do të ketë ekspertizë teknike, ekspertizë ligjore, ekspertizë financiare në aspektin e tepricës së energjisë për këto shtatë shkolla, të cilat realisht janë shtatë shkollat që janë pilotuar nga implementimi i projektit të dy viteve të mëparshme, ku është konstatuar që ka tepriçë energjie, po teprica e energjisë për shkak të vakumit ligjor mbetet kosto, dhe jo investim. Po, patjetër. Po, patjetër. Edhe shtatë shkollat të japur? Jo, jo, bëhet fjalë për bashkinë e Elbasanit, nuk bëhet fjalë për Qarkun. Jemi bashki dhe kemi aplikuar si bashki. Po, patjetër. Po, qytetet dhe njësitë administrative. Keni Jorgjin Dilon, Suleman Rancin, Shkolla Europa, Luigj Gurakuqi, Ptoleme Xhuvani, Abdul Paralloji. Po. Tani janë të shtatë shkollat për të cilat është përfituar fondi nga OSF-ja e Eëstern Balkan nga implementimi i dy viteve të mëparshme, po, patjetër, dhe tani do bëhet kthimi i këtij investimi në një investim të qëndrueshëm, për shkak se teprica e energjisë në këto shtatë shkolla nuk kthehet në investim, por është kosto, sepse bashkitë e njësitë të vetëqeverisjes vendore për shkak të vakumit ligjor nuk mund ta kthejnë në investim këtë tepriçë energjie, sidomos gjatë tre muajve të verës, ku shkollat janë të mbyllura dhe realisht atyre ka dhe tepriçë më shumë, por që mbetet humbje, për shkak se nuk mund të ndërhyjnë për shkak të vakumit ligjor që kanë dhe pamundësisë së njësitë të vetëqeverisjes vendore.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit, Kristina. Hapet votimi?

Kristina Kreka-Përfaqësuese e administratës Bashkia Elbasan

Bëhet fjalë për shkollat. Tek ato shkolle që ka pasur partneritet dhe suport nga donatori, nga OSF Eastern Balkan, nga një fazë e mëparshme të zbatuar nga pikërisht ky donator. Sepse donatori ka qëndrueshmërinë e investimit dhe qëndrueshmëria e investimit është se si ti sot do ta marrësh të qëndrueshëm për ta kthyer këtë teprice energjie në investim. Normalisht, vakumi ligjor nuk i lejon njësitë e vetëqeverisjes vendore. Atëherë, nëpërmjet këtij mekanizmi që është komiteti i efikasitetit të energjisë, kjo ekspertizë të kthehet në një manual standard në nivel kombëtar, duke lobuar pranë pushtetit qendror për përmirësimin e bazës ligjore, në mënyrë që njësitë të kenë akses për ta futur në gjenerim të ardhurash.

Fatmir Vodollari-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në qoftë se ne e stimulojmë nëpërmjet projektit vënien e këtyre paneleve dhe të shtëpitë private, atëherë ato janë më të interesuar të ngrohen me kondicioner sesa me dru. Edhe jep një lloj zgjidhje për atë që ngriti Ergysi, zoti Muzhaqi, për këtë po të pyes. Domethënë, kjo është një fazë.

Asim Sula-Nënkryetari i Bashkisë Elbasan

Okej, për ta kuptuar më mirë dhe për të qenë të qartë, Kristina e sqaroi shumë mirë këtë aspekt, por faktikisht kemi boshllëk ligjor për sa i përket sistemit dhe shfrytëzimit të energjisë dhe transmetimit të energjisë nga panelet fotovoltaike. Pra, ky grup që do të ngrihet do të advokojë në sistem lokal dhe në sistem qendror për të zgjidhur këto boshllëqet ligjore dhe të bëhen sa më efikente funksionimi i paneleve fotovoltaike. Pra, e ndihmon shumë procesin edhe në godinat tjera, nuk do shërbejë vetëm për këto godina, por do të jetë një relacion pastaj që do të mbulojë, do të advokojë në sistem qendror dhe lokal për të zgjidhur këto boshllëqe ligjore. Dhe do të krijohet sigurisht një platformë në sistem për të bërë një matje të saktë të gjenerimit të energjisë nga panelet fotovoltaike.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit. Hapet votimi?

Hektor Cifjta-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kërkoj shumë ndjesë nënkryetar Z. Asim Sula, që nuk e kam parë materialin deri në fund, por sa do të jetë fondi, këtu bëhet fjalë për një projekt që ne do të aplikojmë, apo jo? Kjo është për i shikon projekt i fituar. Sa kemi fituar ne si projekt?

Asim Sula-Nënkryetari I Bashkisë Elbasan

Atëherë, është aplikuar, është fituar projekti, bëhet fjalë për të lidhur marrëveshjen. Pra, lidhet marrëveshja në parim dhe projekti financohet nga donatorët e gjithë, nuk ka bashkëfinancim nga bashkia për këtë pjesë.

Hektor Cifjta-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Dhe kjo i shkon në bashkisë së Elbasanit?

Pra, do të kemi shkolla më të ngrohta. Faleminderit.

Pra, ne jemi një hap përpara Evropës.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga




Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 14 e rendit të ditës.

Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan. për sezonin sportiv vjetor 2026.

Mirand Backa-Përfaqësues I Administratës Bashkiak Elbasan

Atëherë, në lidhje me materialin që keni përballë, është një material që neve e bëjmë për vit dhe ndryshojmë atë vitin, domethënë është konform ligjit. Për sa i përket pyetjes tuaj, shpresa për shembull, tek volejboli apo ndonjë ekip tjetër e basketbolli, ka dhe tek volejboli, ka dhe tek harku. Neve kemi vënë këtu numrin e trajnerëve dhe sportistëve të cilët trajtohen. Pra, nuk do të thotë që kemi ekip me trajnerë pa sportistë. Normalisht, sportistët ndahen në dy kategori: profesionistë dhe amatorë. Profesionistët paguhen, amatorët nuk paguhen. Vetëm ai, madje amatori mund të ketë rezultat më të lartë se profesionisti, vetëm se paguhet, kjo i dallon. Por dhe këta, askush nga këta këtu nuk quhet profesionist, sepse trajtimi është trajtim ushqimor, nuk është kontratë, pra, është diet, nuk është pagë. Domethënë, askush nuk quhet .Pra, aty nuk do të thotë që nuk ka të rinj apo nuk ka shpresa, por aty, sepse neve kemi me qindra, por këta që mbulon bashkia mbështet me trajtim. Nëse do të kishte një menc, për shembull, po, ia japin në vlerë të asaj, domethënë kjo është ideja, në vlerë monetare.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit. Atëherë, unë nuk do të futem me këto shifrat që na janë paraqitë këtu. Në qoftë se drejtoria ka sjellë këto shifra, do t'i maratoj. Domethënë, e kam votën time pro, por kam një shqetësim tjetër. Në një farë mënyre, i para periudhe kjo pika paneleve diellore, këtë shqetësimin që kam. Janë ca shifra këtu, kaq trajnerë, kaq sportistë, qysh edhe vetë drejtori, që nuk ka profesionist, po ka amator. Këto janë shifra që tregojnë për nivel të ulët të sportit në bashkinë e Elbasanit, në klubin shumë sportesh. Ne kemi pasur shembuj të mirë, por kemi pasur edhe shembuj katastrofikë. Shembulli i mirë më duket se është ekipi i futbollit, i cili u nis nga zero, u gjetën njerëzit, burimet, financat, etj, dhe sot është mos gaboje në kategori sipërore edhe lum për kampion, se nuk e ndjek më. Shembull shumë i mirë. Shembulli katastrofik më se ne, që e kam shprehur, ambledën e kaluam me para dy mbledhjesh, ku ishte kryetari Llatja, qysh i lam ne të na iki Enkeleda Carja, me Englantinën që e keni pasur kolege këtu, Antare Këshillit. Pra, se për shembull, Mirandi vetë është mjeshtër edhe trajner edhe kampion i karates, edhe familjarisht është investu në karate me shumë sukses. Megjithatë, duhet të pranojmë që karateja nuk është një nga sportet që tërheqin shumë vëmendje publike apo shumë investime nga biletat e nga këto. Kurse peshngritja është një sport që tërheq, apo ndonjë sport tjetër që ne kemi mundësi edhe të shfaqim vlerat e sportistëve tanë, edhe të tërheqim interes kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo do të thotë, pse për këto sportet e spikatura, siç është, po përsëris edhe herë tjetër, rasti i Enkeledës, që ka dalë kampion e botë me thyerje rekordesh botërore qysh 17 vjeç, edhe na ka marrë Teuta, pse nuk i gjejmë dot neve këto financimet? Në qoftë se është një shqetësim, siç kam folur me Bacën, edhe thotë që kemi ngërç ligjor që na pengon të pranojmë sponsorizime. Nuk e di tashi, se nuk e kam shqyrtu me vëmendje këtë, por e para, në qoftë se u tejkalu ky ngërç, ngërç për çështjen e akademisë së futbollit të Elbasanit, tejkalohet edhe për peshngritjen, e para. E dyta, në qoftë se u dash të bëhej betejë ligjore, unë i pari, na sillni çdo lloj propozimi që i takon Këshillit Bashkiak, konkret fare për Enkeledën edhe Englantinën, janë dyshe shumë e suksesshme, t'i marrim, t'i kemi në Elbasan, t'i promovojmë, t'i mbështesim, si të jetë, të bëjmë i gjë, domethënë, si Këshill Bashkiak, se unë s'më rrëshqet poshtë kjo që na ka ikë ajo goca, qysh 16 vjeç e morrën tjerët, edhe në 17 vjeç bëhet kampione bote. E prodhojmë ne, e shfrytëzojnë tjerët, edhe prestigjin, edhe benefitet që vijnë prej kësaj, domethënë,

prej kujt diç unë, prej rroga, prej kujt diç unë për çfarë, dhe paska gjetur durrësi, rrogën ta gjejme edhe ne.

Dritan Ceca-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Për sportisten Engeleda Carja, ajo ka ikë nga bashkia e Elbasanit për 60 mijë lek të reja, që është vendim i Këshillit të Ministrave, e cila detyron njësinë e qeverisë vendore, praktikisht Bashkinë e Elbasan, ka dalë vullnetare bashkia Durrësit dhe ka marrë një kampion e botë për 60 mijë lek në muaj, që është trajtim ushqimor, shqetësim me të cilin unë e kam ndarë për dikë tjetër me zotin nënkryetar, bashkia e Elbasanit refuzon ta paguajë këto 60 mijë lek këtë muaj, që ta dinë të gjithë. Pavarësisht se e ka detyrim ligjor.

Po jo, ka dhe kampione të tjera. Ke kampione ballkanike, pingpong, është një vajzë 10 vjeçare, janë dy motra. Kampione e Europë. Edhe Mirandi vetë ka 6-7 kampione.

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Sillen në këshill bashkiak, unë mendoj që do ta miratojmë.

Dritan Ceca-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Është detyrim ligjor, s'kemi ne çfarë miratojmë, është vendim i Këshillit të Ministrave, është e shkruar, e zezë mbi të bardhë.

Miranda Backa-Përfaqësues i Administratës Bashkiak Elbasan

Atëherë, shqetësimin e kemi për bashkët, neve na ka dhënë më shumë kur është larguar enkeleda, por ajo që desha të thosha unë është se, domethënë, unë ju falënderoj për sa i përket që na sillni gjithçka, do ta miratojmë unanimisht, shumë faleminderit për mbështetjen, por ajo që desha të prekja, është se Elbasani nuk është, me këtë materialin këtu, me këto shifrat këtu, nuk është tregues që është në nivel të ulët sportiv. Për sa i përket ekipeve sportive, domethënë, të gjitha sportet individuale, përjashtoj volejbol, basketbol, se edhe hendbolli është kampion kombëtar, karate, peshngritje, alpinizëm, çiklizëm, pingpong, atletikë, judo, çiti, radimatrizëm, boks, not, hark, ne jemi kampion, jemi kampion, i ke të gjithë trajnerë kombëtarë. Pra, kjo nuk tregon që është nivel i ulët i sportit në Elbasan. Domethënë, ajo që kemi diskutu bashkë ka qenë ligji i sponsorizimit që po

vonohet, po diskutohet atje me radhë, që s'e ka ndarë fare bashkia. Po, tashi, jo, domethënë, kisha në lidhje me parlamentin, kurse ajo që desha të thosha unë, pra po tek sporti, tek puna e klubit të shumësportazh, domethënë, neve aq emër të mirë kemi bërë në Shqipëri, sa që po na kërkojnë nga Durrësi, se Durrësi tash është një shkrirje, kanë vajtë nëpër SPAK këta, apo Tiranës këta shefat, ngaqë kanë dhënë këto, kanë bërë këto gjëra kështu, domethënë, kanë përfundu atje. Domethënë, ju lutem, jo, , pra, ideja është, ideja është kjo, nga Durrësi, po atletë na kërkojnë neve, kampionw nw fuqi të vijnë, kanë treguar për ekipin e Elbasan, çitja të vijë, këtu kampion fuqi, vetë, vetëm na pranoni, thotë, në pingpongu gjithashtu, në Kosovë, në Greqi, në Gjermani, nga Durrësi kërkon të vijë kjo atletja, domethënë, pra, niveli i sportit shumë i lartë, po bëhen nga, vetëm këtë vit do bëhet ballkaniku i xhudos në Elbasan, evropiani i peshngritjes në Elbasan, pasi se peshngritja ju tha tërheq më shumë, nuk e di çfarë tërheq më shumë, tifoza nuk tërheq më shumë se karateja, se janë filma në aksion që të këpusin, domethënë, po të vish pala sportit karate ske vend ku tw ulesh peshngritje nuk gjen dot.

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, 1- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(vota kundwr I.Sadiku)


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 15 e rendit të ditës.

Për miratimin e Kodit të Sjelljes 2025 të ndryshuar.

Lorena Haxhiymeri-Pwrfaqwsuese e administratws Bashkia Elbasan

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak, thjesht kërkohet shfuqizimi i kodit të sjelljes që është miratuar me numër VKB 105, datës 3.9.2025. Janë rishikuar disa nene, riformulimi i të cilave është bërë me kërkesë po të anëtarëve të grupit që e kanë hartuar atë, dhe ju lutem të miratohet kodi i sjelljes së administratës së bashkisë Elbasan, me ndryshimet që ju i keni në relacionin përkatës.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirë, pra tash është një pikë që duhet të sqarohemi. Ka të bëjë me komunikimin me media, nenet e ndryshuara. Riformulim duke qartësuar se vetëm zyrtarët e autorizuar komunikojnë në emër të institucionit. Mund të jesh më specifike kush është ai që do autorizojë nga institucioni

Lorena Haxhiymeri-Pwrfaqwsuese e administratws Bashkia Elbasan

Atëherë, në bashkinë e Elbasan është një sektor përkatës për marrëdhëniet me publikun, e cila ndodhet dhe për ku është i përfshirë dhe sektori i mediave, dhe është shumë e mirë që çdo pyetje që ne na vjen nga jashtë në marrëdhënie me institucionet e jashtme, kryesisht nga media, kërkon një konsultim dhe një riorganizim, qëndërzim të informacionit që del nga bashkia. patjetër që do jetë në nivel kryetari ose nënkryetari të linjës përkatëse. Nënkryetari i linjës përkatëse, meqënëse sektori ndodhet pranë drejtorisë të teknologjisë dhe mediave, dhe është

sektori me emërtimin marrëdhënie me publikun, patjetër që do ketë dhe një harkim përkatëse për të deleguar çdo informacion. Shfuqizohet kodi i sjelljes që ne e kemi miratuar në 2025-ën dhe vjen në fuqi ky kod.

Zamir Muzhaqi-Nwnkryetar I Kwshillit Bashkiak Elbasan


Këtu administrata, jo e gjitha, ka të drejtë të bëjë dalje publike dhe të flasin në emër të administratës.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, - kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(vota Abstenim Y.Balliu,A.Domi,A.Kana,A.Mecja)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga




Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.01.2026, ora 13:00 në ambjentet e sallës së këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Elsid Zyma, ZV. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 16 e rendit të ditës.

Për miratimin e përdorimit të një pjese të fondit të Mbrojtjes Civile për vitin 2026 për kryerjen e investimeve parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese, në Njësitë Administrative Tregan, Gjergjan, Shushicë, Shirgjan dhe Labinot-Fushë, për riparimin e dëmeve të shkaktuar nga shirat masive të rëna në datat 3-8 Janar 2026.

Asim Sula-Nwnkryetari I Bashkisw Elbasan

Fatkeqësisht gjatë ditëve të para të muajit janar, Bashkia e Elbasan dhe territori ynë më tepër probleme ka pasur nga reshjet e shiut dhe se sa nga reshjet e dëborës. Me drejtorinë e mbrojtjes civile kemi evidentuar në terren disa rrëshqitje dheu që janë problematike, jo vetëm problematike për moskallimin e rrugës, por problematike edhe për banesat që rrezikohen nga këto shembje dhe rrëshqitjet e dheut. Për këtë arsye, drejtoria e mbrojtjes civile ka hartuar dokumentacionin e nevojshëm në bashkëpunim me agjencinë e shërbimeve publike rurale për t'i ardhur në ndihmë dhe për të riparuar sa më shpejt këto dëme të shkaktuara nga reshjet e shiut. Pra, bëhet fjalë për një fond ke 5 milion 350 mijë lekë që i kalon në dispozicion të agjencisë së shërbimeve publike rurale për të zgjidhur sa më shpejt këto problematika që mund të rëndohen nëse zgjaten më shumë ose mund të krijojnë probleme më të mëdha nga rrëshqitjet e shkaktuara.

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, - kundër, -abstenim, miraton sa më sipër.


Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

